

## **MARREVESHJE**

**E LIDHUR SOT ME DATE 26.07.1993**

**midis**

**MINISTRISE SE INDUSTRISE, BURIMEVE MINERARE DHE ENERGJETIKE**

**dhe**

**ALBPETROL-it, BASHKESISE EKONOMIKE TE NAFTES DHE GAZIT**

### **OBJEKTI: Autorizim per kryerjen e Operacioneve Hidrokarbureve.**

Ministria e Industrise, Burimeve Minerare dhe Energetike, me ane te kesaj Marreveshje autorizon Albpetrol-in te kryeje Operacione Hidrokarbure ne perputhje me Licensen e miratuar nga Ministria e Industrise, Burimeve Minerare dhe Energetike, per cdo objekt te cituar ne listat "A" dhe "B" te kesaj Marreveshje. Licensa eshte Marreveshja e lidhur midis Ministrise dhe Albpetrol-it ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe standartet me te mira te industrise nderkombetare. Licensimi do te filloje 45 – dite pas nenshkrimit te ketij dokumenti.

1. Per vendburimet egzistuese te paraqitura ne listen "A" bashkangjitur kesaj Marreveshje, Operacionet Hidrokarbure, jane:
  - 1.1 Vazhdimi i Operacioneve egzistuese per prodhimin e hidrokarbureve.
  - 1.2 Reabilitimi dhe modernizimi i teknologjive per rritjen e prodhimit te hidrokarbureve.
  - 1.3 Realizimi i projekteve pilot si baze per zbatimin e metodave te veprimit ne shtrese.
  - 1.4 Zbatimi i metodave te veprimit ne shtrese per rritjen e koeficientit perfundimtar te naftenxjerrjes.
  - 1.5 Zbatimi i metodave te ndryshme per shfrytezimin dhe perpunimin e rerave bituminoze.

Per realizimin e pikave 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, Albpetrol-it i jepet e drejta te bashkepunoje me persona juridike vendas dhe te huaj si dhe institucionet financiare derkombetare ne perputhje me standartet dhe praktikat me te mira te industrise nderkombetare te naftes.

Per kete qellim do te lidhen Marreveshje Hidrokarbure midis Albpetrol-it dhe Kontraktorit, sipas Licenses se leshuar nga Ministria e Industrise, Burimeve Minerare dhe Energetike, qe do te ratifikohen nga Keshilli i Ministrave.

Termat dhe kushtet qe do te perfshihen ne kete Marreveshje do te jene ne

perputhje me Legjislacionin Shqiptar.

2. Per zonat e kerkimit, bashkangjitur ne listen “B” te kesaj Marreveshje, Operacionet qe do te kryhen jane:

- 2.1 Vazhdimi i Operacioneve egzistuese per kerkimin, zhvillimin, prodhimin dhe cdo operacion tjeter qe lidhet me to.

Per realizimin e pikes 2.1, Albpetrol-it i jepet e drejta te bashkepunoje me persona juridike vendas dhe te huaj si dhe institucione financiare nderkombetare ne perputhje me standartet dhe praktikat me te mira te industrise nderkombetare te naftes.

Per kete qellim do te lidhen Marreveshje Hidrokarbure midis Albpetrol-it dhe Kontraktorit, sipas Licenses se leshuar nga Ministria e Industrise, Burimeve Minerare dhe Energjetike, qe do te ratifikohen nga Keshilli i Ministrave.

Termat dhe kushtet qe do te perfshihen ne kete Marreveshje do te jene ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar.

3. Ministria mund te autorizoje edhe Albpetrol-in qe te hyje ne Marreveshje Hidrokarbure me persona juridike te huaj edhe per zonat qe nuk perfshihen ne listat “A” dhe “B”.
4. Ministria e Industrise, Burimeve Minerare dhe Energjetike, ne bashkepunim me Albpetrol-in mund te gjykoje te nevojshme qe se bashku ose vecmas te kene te drejten e pjesmarrjes ne fazen e zhvillimit ne vendburimet e mundshme qe do te zbulohen nga Kontraktoret e huja ne te ardhmen.

**I autorizuar dhe ne emer te**

**MINISTRISE SE INDUSTRISE, BURIMEVE MINERARE DHE ENRGJETIKE**

**Ministri**

**Abdyl XHAJA**

**I autorizuar dhe ne emer te**

**BASHKESISE EKONOMIKE TE NAFTES DHE GAZIT, ALBPETROL**

**Drejtori Ekzekutiv**

**Bahri SHANAJ**

## **LISTA "A"**

### **VENDBURIMET E NAFTES**

#### I. Vendburimet Gelqerore :

1. Vendburimi Gorisht - Kocul
2. Vendburimi Amonice
3. Vendburimi Ballsh - Hekal
4. Vendburimi Cakran - Mollaj
5. Vendburimi Visoke

#### I.1. Objekte shfrytezimi ne gelqerore

1. Gelqeroret e Zharrzes
2. Gelqeroret e Kallm - Verrise
3. Gelqeroret e Drashovices

#### II. Vendburimet Ranore

1. Vendburimi i Kucoes qe perfshin
  - a. Shtratimet e Arrzes
  - b. Shtratimet e Kucoes
  - c. Shtratimet gjirit 540, Ciflik Poshnje
  - d. Shtratimet e Rase-Murrriz-Pekisht
2. Vendburimi Patos - Marinez
  - a. Objekti Bubullima
  - b. Objekti Nr.2 Marinza
  - c. Objekti Nr.1 Marinza
  - d. Objekti Driza
  - e. Objekti Gorani
3. Objekti i shfrytezimit "Neogen Kallm" (Suita Bubullima)

### **VENDBURIMET E GAZ-KONDENSATIT**

1. Vendburimi i Divjakes
  - a. Objekti i Pliocenit
  - b. Objekti i Tortonianit
2. Vendburimi Ballaj - Kryevidh

3. Vendburimi Frakull
4. Vendburimi Povelce
5. Vendburimi Panaja
6. Vendburimi Finiq (i abandonuar)
7. Vendburimi Durres (i abandonuar)
8. Vendburimi Delvine (gaz-kondensat)
9. Vendburimi Kolonje (gaz-kondensat, i abandonuar)
  - a. Zona e Bubullimes
  - b. Zona e kallmit

## **VENDBURIMET E RERAVE BITUMINOZE**

1. Vendburimi Kasnice
2. Vendburimi Visoke
3. Vendburimi Treblove

## **LISTA "B"**

## **OBJEKTTET E KERKIMIT**

1. DUMRE
2. PANAJA
3. VELCE
4. DELVINE

